



# NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C.

Part of BALFIN. Balkan Finance Investment Group

## NJOFTIM PUNE

**Balfin Group** është një ndër grupet private investuese më të mëdha në Shqipëri dhe rajon, i pranishëm me aktivitetet për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, shitjet me pakicë, ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e hapsirave tregtare apo industriale, telekomunikacion, industria minerare, financime dhe programe besimi për konsumatorët.

NewCo Ferronikeli Complex L.L.C është pjesë e Balfin Group dhe operon në sektorin e Industrisë së Minierave.

**Pozicioni:** Inxhinier i Mekanikës  
**Departamenti:** Mirëmbajtje  
**Lokacioni:** Drenas, Kosovë

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Organizon dhe menaxhon ekipin, përgatit dhe mbikqyr planet dhe preventivat
- Përgatit vlerësime të detajuara të sasive dhe kostot e materialeve dhe punës së nevojshme, sipas specifikimeve të dhëna
- Miraton nevojat të ndryshme në lidhje me mjetet dhe makineritë që nevojiten bazuar në kërkesat e Departamenteve
- Përgatit dokumentacionin për projektet, përfshirë dizajnet, specifikacionet teknike, parametat dhe paralogaritë, tërë dokumentacionin teknik
- Mbikqyr punët e instalimeve mekanike të projekteve në punishte dhe kontrollon raportin e punës në baza ditore
- Asiston dhe bashkëpunon ngushtë me departamentet e Mirëmbajtjes dhe Prodhimit për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm të fabrikës
- Mirëmban dokumentacionin / vizatimet e duhura të pajisjeve
- Përgatit manuale për mirëmbajtjen dhe prodhimin e pajisjeve të reja dhe të modifikuara
- Hartim i listave të detajuara të materjaleve për prokurim ose për prodhim, (monitorim, kontroll dhe verifikim teknik i porosisë sipas kërkesës)
- Monitorim i ecurisë së punës, cilësisë, kostove, proceseve të instalimit dhe hartim të dokumentacionit përkatës
- Bënë vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre në përputhje me standardet e kërkuara

### Kualifikimet dhe Aftësitë:

- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
- Përvojë pune së paku 5 vite në pozicione të ngjashme
- Të ketë njohuri shumë të mira kompjuterike: Microsoft Office, Autocad, Microsoft Project,
- Shkathësi të mira komunikuese dhe organizative
- Duhet të ketë njohuri të mira të Gjuhës Angleze (obligative)

### Mënyra e aplikimit:

Kandidatët e interesuar janë të lutur të dërgojnë CV-të e tyre së bashku me letër motivimi dhe dokumentet përcjellëse më së largu deri më **08/02/2020**, në adresën e e-mailit [hr@ferronikeli.com](mailto:hr@ferronikeli.com) duke përcaktuar në subjekt pozicionin "Inxhinier i Mekanikës"

\*Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë dhe vetëm kandidatët që do të përzgjedhen në listen e ngushtë do të kontaktohen.



Besim Mala Street no.227, 13000 Gllgoc, Republic of Kosovo, Phone: + 383 (0)38 585 000, Fax: + 383 (0) 38 585 109

NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C. is part of BALFIN, Balkan Finance Investment Group

